

## **A MUND TË FITOHET NJË LEJE PUNE NË ZVICËR DHE KUSH JANË KUSHTET N'VARËSISHT NGA ORIGJINA E PERSONIT ?**

### **Çfarë praktikash të pranimit në tregun e punës?**

Të shumtë prej nesh jemi në dijeni se për personat shtetasë të bashkësisë evropiane (në parjashtim të anëtarëve që kalojnë një fazë tranzitore, siç është për shembull Kroacia), çështja e lejes së punës dhe e qëndrimit është një formalitet jashtëzakonisht i thjeshtë. Për fitimin e lejes së punës, mjafton me patur një kontratë pune të nënshkruar apo disa herë mjafton edhe një letër e një punëdhënësi i cili premtim një punë apo lidhjen e arrdshme të një kontrate të punës. Në ditën e sotme, nuk ekziston asnjë kufizim në numër për angazhimin e personave që vijnë nga shtetet e Bashkësisë evropiane. Sa i përket respektimit të procedurës, akti i parë që duhet bërë nga personat e interesuar, duhet me e gjetur një punë (preferohet me kontratë, e jo vetëm një formë premtimi), e pastaj kryhen formalitetet tjera për marrjen e lejes së punës dhe të qëndrimit. Gabim është pra të mendohet e kundërta (së pari leja e pastaj puna !).

Për shtetasit që vijnë nga vendet jashtë Bashkësisë evropiane (Kanadë, SHBA, disa shtete ballkanike, etj), procedura për fitimin e një leje të punës është drastike dhe tejet e ashpër. Refuzimet ndodhin shpesh. Aplikohet sistemi i kontigjentëve vjetore (caktimi i një numri të kufizuar të lejeve). Kërkohej nga kandidati që bënë kërkesën të posedojë kualifikime shumë të larta profesionale. Në mes tjerash, autorizimi i punës kushtëzohet edhe me vendin e punës që i propozohet tij, dhe duhet dëshmuar edhe ajo se për punën e propozuar është vështirë të gjinden kandidatë të mjaftueshëm në tregun e mbrendshëm të punës në Zvicër. Kështu, kërkohej nga punëdhënësi që të prezantojë dëshmi të mjaftueshme se nuk ka arritur të gjejë kandidatë të konvencueshëm apo të mjaftueshëm në tregun zvicran. Thjeshtë është fjala për kategori personash për të cilët ekonomia zvicrane ka nevojë të madhe. Punëdhënësit janë ata të cilët duhet të mbrojnë dosjen e kandidatit. E cekim edhe atë se punëdhënësit e ndryshëm nuk e kanë të njëjtën peshë para autoriteteve administrative që vendosin (për shembull, dallime ekzistojnë në mes të një punëdhënësi siç është industria farmaceutike « Novartis » dhe një ndërrmarje të vogël të ndërtimitarisë).

### **Pse ekzistojnë kaq shumë dallime në mes të dy sistemeve të pranimit në tregun zvicran të punës?**

Marrëdhëniet që e lidhin Zvicrën me shtetet e Bashkësisë evropiane bazohen në marrëveshjet bilaterale (të dyanshme) të cilat parashikojnë posaçërisht që trajtimi në tregun e punës të jetë i barabartë dhe pa diskriminim në mes të shtetasve zvicranë dhe atyre që vijnë nga shtetet e Bashkësisë evropiane. Dihet pra se është pikërisht kjo e rregullë e cila u ka mundësuar shumë bashkatdhetarëve tanë, që posedojnë pasaportën e vendeve që na rrethojnë (Itali, Gjermani, etj), të integrohen në tregun zvicran të punës.

Kurse për personat që vijnë nga shtetet jashtë Bashkësisë evropiane, aplikohet ligji për të huaj, i cili përmbanë shumë pakë rregulla të ngjajshme me ato të marrëveshjeve bilaterale. Ligji i tillë historikisht karakterizohet me rregullat e tija tejet të ashpra. Pikërisht, bashkatdhetarët tanë që punojnë në vendet që na rrethojnë dhe që nuk posedojnë shtetësinë e vendeve përkatëse (por vetëm një leje qëndrimi apo pune), iu nënshtrohen pra rregullave të këtij ligji. Po e njëjta gjë mund të thuhet edhe për personat që jetojnë në viset tona (Kosovë, Maqedoni, etj.). E vetmja rrugë që do të mundësonte fitimin e një leje pune e hasim në sistemin e kontigjentëve (në përjashtim të rasteve të fitimit të lejes

përmes lidhjeve martesore apo të bashkimit familjarë). P.s. lidhur me temën e bashkimit familjarë mund të lexoni artikullin tonë në «dosje tematike».

### **Çka mund të thuhet për sistemin e kontigjentëve?**

Sistemi i tillë nënkupon se, për çdo vitë, caktohet numri i personave që do të kenë të drejtë të fitojnë lejen e punës në Zvicër. Kjo praktikë e llogaritjes aplikohet pra vetëm për personat që i nënshtrohen ligjit për të huaj.

Sipas një vendimi të muajit të kaluar, Këshilli federal vendosi që në vitin 2017 të risë numrin e kontigjentëve për lejet B dhe L (leje me afate të shkurtëra). Kjo ishte një rezultat i një presioni që bënin aktorët ekonomik, të cilët, tepër e më tepër, konsideronin se Zvicra ka nevojë më të madhe për krahun punëtor të kualifikuar që vjen nga shtetet jashtë Bashkësisë evropiane. Por, një vendim i tillë natyrisht se nuk besohet se ka ndonjë ndikim të madhë për ndryshimin e situatës për vendet tona. Në fakt, me rritjen e numrit të kontigjentëve, rritet vetëm numri i personave që do të kenë mundësi të gjejnë punë, por jo edhe kushtetet që aplikohen për hyrje në punë sipas rregullave tejet të ashpra të sistemit të kontigjentëve. Siç e cekëm më lartë, vetëm personat me kualifikime tejet të larta mund të përfitojnë nga ky sistem i pranimit. Personat që përfitojnë më së tepërmi nga kjo janë si zakonisht ekspertë të lëmive të ndryshme që vijnë nga SHBA, Kanada dhe disa shtete aziatike. Një numër jashtëzakonisht simbolik vjen nga shtetet ballkanike.

### **Çka pritet në të ardhmen ?**

Nuk ka vendë për një optimizëm të tepruar në këtë drejtim.

Së pari, sipas një iniciative të së djathtës ekstreme në Zvicër, kërkohet që deri në fillim të vitit të ardhshëm të definohet çështja e kontigjentëve edhe për shtetet e Bashkësisë evropiane, edhe atë në përputhje me rezultatet e votimit për kufizimin e numrit të të huajve. Gjithë kjo mbetet të qartësohet gjatë muajve që vijnë dhe sipas të gjitha gjasave situata e tashme do të pësojë ndryshime, duke filluar me aplikimin e njëfarë kufizimi të numrit të personave që vijnë nga shtetet përkatëse. Nënkuptohe se kjo perspektivë do t'i prekë edhe interesat e bashkatdhetarëve tanë që posedojnë pasaportat e vendeve të Bashkësisë evropiane dhe që dëshirojnë të gjejnë punë në Zvicër.

Së dyti, sipas shumë vlerësimeve, nuk pritet aspak që ligji për të huaj të pësojë ndonjë ndryshim rrënjësor. Kjo domethënë se edhe në të ardhmen (së paku të afërt), nuk pritet të ketë ndonjë ndryshim në praktikën e pranimit të personave që vijnë nga shtetet jashtë Bashkësisë evropiane. Ndoshta do të zmadhohet gradualisht numri i kontigjentëve vjetorë, por do të vazhdojë me qenë edhe më tutje jo aq i përshtatshëm për vendet tona.

Zyra për këshilla juridike « BEGZATI »  
Av. J. J. Rousseau 7, 2000 Neuchâtel  
E-mail : Lirim.Begzati@hotmail.com  
Kontakt : 079/354'67'13  
www.cabinet-begzati.ch